



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
URDHRI I INXHINIERIT HIDROTEKNIK
INXHINIERËT HIDROTEKNIK

NIVELI I KUALIFIKIMIT TE HIDROTEKNIKEVE

Çfarë fiton ne Inxhinier Hidroteknik si individë.

Çdo Hidroteknik nëpërmjet ushtrimit të së drejtës së profesionit, minimalisht përfiton pagën minimale referuese, si edhe nëpërmjet certifikimit në vijim nëpërmjet trajnimeve nga QTH-ja, përfiton vlerën e kredite ECTS, si edhe për ata Hidroteknik që do të bëjnë punë kërkimore përfiton vlerën e titullit përkatës. Çdo kredit ECTS, ka vlerë minimale në para që i shtohet pagës minimale refernce.

I. Shpërblimi i Inxhinierit Hidroteknik.

Hidrotekniket ndahen në tre Nivele (kategori) sipas vetë kualifikimit dhe aftësisë së tyre në shërbim

- 1) Niveli i III-të (tretë):
- 2) Niveli i II-të (dytë):
- 3) Niveli i I-rë (parë):

Shpërblimi i Pagës Bruto të Inxhinierit Hidroteknik, për të kryer punë efektive dhe cilësore minimalisht do të vlerësohet si më poshtë.

Shënim;

*Në baze dhe zbatim të pikës 9, të nenit 38, të ligjit organik, Inxhinieri hidroteknik gjatë ushtrimit të profesionit mund të vlerësohet dhe të zhvillojë karrierën e tij profesionale **në tre nivele kualifikimi**, sipas përcaktimit nga Këshilli Kombëtar i Urdhrit.*

1) Niveli i III-të (tretë):

Shënim;

në bazë dhe zbatim të pikës 12, të nenit 38, të ligjit organik, si edhe në baze të VKM-së ...

Inxhinieri Hidroteknik në momentin e përfitimit të titullit Inxhinier Hidroteknik i lind e drejta të kërkojë dhe do të paguhet minimalisht **90 000** (është ende në diskutim) lekë/muaj (bruto).

Çdo inxhinier përfiton nga çdo punëdhënës fee, për të drejtën e përdorimit të titullit Inxhinier Hidroteknik, përkatësisht shumë prej 10.000 leke/muaj në bazë dhe zbatim të pikës 4, të nenit 38, të ligjit organik.

Shënim;

*Në baze dhe zbatim të pikës 1, të nenit 50, të ligjit organik. QTPH-ja do të ofroj veprimtari mësimore dhe trajnuese, me ngarkesë përkatësisht 10 deri 30 kredite (ECTS), që finalizohen me lëshimin e certifikatave profesionale dhe **vlerësimin e krediteve përkatëse, kjo vlerë i shtohet pagës minimale reference (bruto), sipas parashikimeve në ligjin organik.***

2) Niveli i II-të (dytë):

Inxhinieri Hidroteknik pas përfitimit të titullit Inxhinier Hidroteknik i lind e drejta të marrë pjesë në trajnime dhe kualifikime sipas grupimeve teknike dhe të kryej edukime të vazhdueshme gjatë karrierës së tij.

Këto trajnime janë bazë për të marrë të drejtën e ushtrimit të profesionit për atë pjesë shërbimesh që do të pajiset me certifikata dhe i vlerësuar me kredite ECTS;

Inxhinieri Hidroteknike i kualifikuar në Nivelin e II-te, ushton të drejtën e profesionale në shërbimet;

- a) Studim Monitorim,
- b) Projektim,
- c) Menaxhim të Projekteve.
- d) kryen shërbim për një periudhë 10 vite;

Inxhinieri Hidroteknik në momentin e përfitimit të Krediteve i lind e drejta të kërkojë dhe do të paguhet minimalisht 90 000 lekë/muaj (bruto) + Vlerën e Krediteve (bruto), si dhe përfiton nga çdo punëdhënës fee, për të drejtën e përdorimit të titullit Inxhinier Hidroteknik, përkatësisht shumë prej 10.000 lekë/muaj në bazë dhe zbatim të pikës 4, të nenit 38, të ligjit organik.

3) Niveli i I-rë (parë):

Inxhinieri Hidroteknik për tu kualifikuar në nivelin e I-rë (parë), duhet të ketë ushtruar profesionin për një periudhë kohore 10 vite referuar këtu;

- 1) Nivelit të II-te (dyte) të kualifikimit dhe duhet të jetë vlerësuar minimalisht me kredite ECTS (e vendos urdhri) si me poshtë;

a) Menaxhim të Projekteve,	200 kredite
b) Projektim,	200 kredite
c) Studim Monitorim.	200 kredite
- 2) Ky kusht është i parashikuar edhe në Kodin e Procedurës Civile të RSH-se, në nenin 224/b, pika 3, ku thuhet që: *Ministria e Drejtësisë pranon regjistrimin e ekspertit në regjistrin elektronik, nëse ai përmbush kriteret e mëposhtme: germën a), të ketë dhjetë vjet përvojë profesionale në fushën specifike apo të ngjashme. Pesë vjet përvojë profesionale e këtij lloji është e mjaftueshme nëse aplikanti ka përfunduar një trajnim profesional në fushën përkatëse; germa b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar; germa c) të jetë i regjistruar dhe të ketë përmbushur në mënyrë të rregullt detyrimet në organet tatimore.*

Inxhinieri hidroteknik (Eksperti) për tu vlerësuar në Nivelin e I-rë të kualifikimit, i lind e drejta të trajnohet dhe të pajiset me certifikatën dhe vlerësimin përkatës të krediteve ECTS, për të ushtruar të drejtën e shërbimeve në;

- a) mësim dhënie (Lektor);
- b) Mbikëqyrje
- c) Kolaudim;
- d) Vlerësim, në Ekspertizë Teknike.

- 1) Inxhinieri Hidroteknik për rivlerësimin e Krediteve i lind e drejta të kërkojë dhe do të paguhet minimalisht 90 000 lekë/muaj (bruto) + Vlerën e Krediteve (bruto) të Nivelit të II-te + Vlerën e Krediteve (bruto) në vazhdimësi të Nivelit të I-re.
- 2) Si edhe përfiton nga çdo punëdhënës fee, për të drejtën e përdorimit të titullit Inxhinier Hidroteknik, përkatësisht shumen prej 10.000 leke/muaj në baze dhe zbatim të pikës 4, të nenit 38, të ligjit organik, ose për të drejtën e përdorimit të titullit Urdhri Profesional Hidroteknik, përkatësisht shumën prej 25.000 lekë/muaj në baze dhe zbatim të pikës 5, të nenit 38, të ligjit organik nëse përfiton këtë titull nga Urdhri.

